



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**  
**BORDI**

---

**VENDIM**

**Nr. 17, datë 18.01.2012**

**MBI**

**SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË VLERËSUESIT TË PAVARUR**  
**Z. ARBEN KOÇIBELLI**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 146 të “Kodit të Procedurave Administrative”, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, pasi mori në shqyrtim ankimin e vlerësuesit të pavarur Z. Arben Koçibelli, me propozim të Departamentit të Çështjeve Juridike,

**KONSTATOI, SE:**

Autoriteti ka licencuar si vlerësues dëmsh në sigurime Z. Arben Koçibelli me licencën nr. 21, datë 25.11.2008.

Me Vendimin e Bordit nr. 163, datë 13.12.2011, është marrë masa administrative e tërheqjes së licencës. Ky vendim është marrë në përputhje me procedurat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative.

Z. Arben Koçibelli ka depozituar në Autoritet ankimin administrativ ndaj këtij Vendimi.

Pretendimet e parashtruara nga Z. Arben Koçibelli në ankimin administrativ, janë të pambështetura në ligj dhe në fakte për arsye se në të gjitha konstatimet, për aktet e vlerësimit të kryera si rrjedhojë e angazhimit të tij nga Gjykata në cilësinë e ekspertit, ka rezultuar se Z. Arben Koçibelli ka shkelur legjislacionin në fuqi në fushën e sigurimeve.

Për sa më sipër, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

1. Lënien në fuqi të Vendimit të Bordit nr. 163, datë 13.12.2011 “Për marrjen e masës administrative ndaj vlerësuesit të dëmeve në sigurime Arben Koçibelli” dhe rrëzimin e ankimit të Z. Arben Koçibelli.
2. Ngarkohen departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në menjëherë.

**NËNKRYETAR**

**Enkeleda SHEHI**